

## **AUDITIMI I PERFORMANCËS SË DUKURIVE SOCIALE TË SHOQËRISË TONË.**

*nga Blerina KËRÇUKU - Audituese<sup>1</sup>*

*botuar n gazetn "Tirana Observer", më 14 mars 2014.*



Kohët e fundit është rritur ndjeshëm interesi mbi çështjet sociale jo vetëm në administratë por edhe më gjerë, si në organizata të shumta, formacione të llojeve të ndryshme qofshin këto sektorë publik apo privat etj. Në kohën e sotme për shkak të buxheteve të shtrënguara publike, administrata e institucioneve, por jo vetëm, duhet të vendosin që të arrijë qëllimet në mënyrë sa më efektive, eficiente dhe ekonomike.

KLSH nëpërmjet auditimeve të performancës i cili synon të orientohet më shumë në rezultate, se sa në proces, duke mbajtur në konsideratë nevojën për ndryshim, për përmirësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm të menaxhimit të administratës publike. KLSH synon që nëpërmjet programeve të miratuara të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë efektive organizatën dhe për të siguruar se ajo është duke punuar drejt ose mbajtjen e një niveli të lartë të performancës. Kriteret e përzgjedhjes synojnë të reflektojnë në lidhje me situatën aktuale të zhvillimit në vend, sfidat e sektorit publik.

KLSH i ka kushtuar një rëndësi të veçantë auditimit për çështje sociale duke vlerësuar performancën e tyre. Këto auditime ndihmojnë që çështje të cilat kanë një impakt të lartë social ti vinë në ndihmë të gjithë palëve të përfshirë. Auditime me specifikime të tilla, ndihmojnë institucionet e caktuara për të identifikuar dhe matur progresin dhe sfidat e tyre, mënyrën e funksionimit dhe organizimit duke përfshirë burimet njerëzore, uljen e riskut, dhe që këto institucione të jenë transparente dhe të përgjegjshme për angazhimet dhe misionin që përfaqësojnë. Ky auditim ofron një qasje objektive për një institucion që të demonstrojë angazhimin për përmirësimin dhe planifikimin strategjik duke treguar përgjegjësi

sociale. NËpËrmjet auditimeve të çështjeve sociale mund të masim kënaqësinë e kërkesave të palëve të interesuara, dhe vetë ato të kuptojnë qëllimet e tyre. Procesi i këtij auditimi ndihmon që kjo organizatë të identifikojë rrisqet dhe detyrimet e mundshme dhe përputhshmërinë me ligjin duke realizuar funksionin primar.

Departamenti i performancës në KLSH, ka ndërmarrë disa auditime të cilat kanë një impakt shumë të madh në shoqëri, si për shembull Shërbimi Hekurudhor, nevoja për ndryshim, Vlerësimi i performancës në furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe largimin e ujërave të përdorura, Dializa në Spitalin Ushtarak, Performanca e Shërbimit Ushqimor Spitalor, Performanca e Shërbimit Parashkollor dhe auditime të tjera të cilat janë në proces.

Në shoqërinë tonë janë bërë problematike shumë dukuri sociale, çelësi i të cilave qëndron në duart e institucioneve përkatëse, të cilat shpesh në mënyrë jo profesionale, në mënyrë të thjeshtë periferike, empirike, edukative dhe pedagogjike, duke luftuar me donkishotizëm pasojat pa ditur shkaqet.

Megjithëse problematika sociale është komplikuar, rëndësia e ndërmarrjes së auditimeve me trajtesë të çështjeve sociale, në mënyrë që tu paraprihet zhvillimeve, të jepen rekomandime, jo vetëm qeverisë, por të gjitha institucioneve dhe strukturave shoqërore për të bërë punë parandaluese, korrigjuese, apo të ndikojë me ndërhyrje për riorientimin social të dukurive që shqetësojnë familjen, shkollën, komunitetin shoqërinë tonë në tërësi.

---

<sup>1</sup> *Shkrime të tjera të botuara nga Blerina KËRÇUKU për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *Mbështetja psiko-socialendaj fëmijëve parashkollorë, prioritet në auditimin e realizuar nga KLSH.*

*(Botuar në gazetën “Tirana Observer”, më 06 qershor2014.)*